

**KONKURS
PËR DHËNIEN E BURSAVE PËR STUDENTË PËR V.A. 2023/2024
Projekti ToKeQark SB NI KOS 09/2023**

Nëntor 2023

Afati i hapur për aplikim: 24 dhjetor 2023

Për The Balkan Forum

The Balkan Forum (BF) është një platformë rajonale shumësektoriale që punon për të shtyrë përpara dialogun ndërkufitar dhe për të krijuar një vizion dhe agjendë të përbashkët rajonale për veprim bashkëpunues në rajonin e Ballkanit bazuar në integrim ekonomik, prosperitet dhe paqe të qëndrueshme. Theksin e kemi tek praktikën e mira të bashkëpunimit rajonal, diskutimet e politikave dhe promovimi i përpjekjeve ekzistuese për të lidhur iniciativat, njohuritë dhe sukseset me nivelet vendimmarrëse që janë përgjegjëse për politikëbërjen dhe integrimin rajonal dhe/ose në BE. Së bashku me partnerët tanë ne fokusojmë përpjekjet tona në plotësimin e mangësive dhe mobilizimin e veprimeve; lehtësimin e ndërtimit të konsensusit dhe dialogut; dhe të vullnetit politik për veprim mbi iniciativat e bashkëpunimit rajonal. Plani Strategjik 2021 – 2025 i The Balkan Forum angazhohet të punojë drejt ndërtimit të kapitalit njerëzor, forcimit të një ekonomie qarkore dhe reduktimit të papunësisë dhe emigracionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Për projektin “ToKeQark”

Aktualisht The BF është duke e zbatu Projektin me titull “ToKeQark” SB NI KOS 09/2023 i cili ka si qëllim parësor promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike duke i trajtuar sfidat mjedisore përmes përfshirjes së komunitetit/palëve në diskutim, si dhe të ofrojë informata të përditësuara lidhur me tranzicionin drejt ekonomisë qarkore në Kosovë e në veçanti, në katër komuna të Kosovës: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Mitrovicë. Projekti financohet nga SMART BALKANS, i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA) dhe zbatohet nga The Balkan Forum.

1. Programi i Bursave

Në kuadër të projektit „ToKeQark“, The BF synon të krijojë një program të bursave si pikënisje duke i shenjestruar/synuar të përzgjedh studentët të merituar të cilët kanë ide dhe potencial në fushat e inovacionit dhe teknologjisë, të ardhmes së gjelbër dhe edukimit për paqen. Qëllimi është të tërheqë dhe/ose mbështesë studentët e universitetit që ndjekin karrierë në këto fusha si një mënyrë për të inkurajuar një brez të ardhshëm të përkushtuar për të krijuar ndryshime pozitive në komunitetet e tyre.

2. Kriteret e konkurrimit për studentë:

- Të jenë banorë të njërës nga këto komuna [Ferizaj, Mitrovicë, Graçanicë dhe Fushë Kosovë]
- Të jenë studentë të rregullt të nivelit bachelor në njërin nga universitetet publike/private;
- Të jenë studentë të vitit të II ose të III të nivelit bachelor;
- Do të konsiderohet si prioritet nota mesatare e studimeve e vitit paraprak;
- Përparësi për marrjen e bursave kanë studentët që studiojnë shkencat natyrore-inovacionit dhe teknologjisë, ekonominë, mjedisin e qëndrueshëm, shkencat politike ose edhe të ndonjë drejtimi tjetër që nuk përmendet këtu, por që mund të jetë me interes të veçantë për këto komuna në përgjithësi;
- Inkurajohen aplikimet nga gratë dhe grupe tjera me status socio-ekonomik të cenueshëm.
- Vlera e një burse do të jetë 125 euro [njëqind e njëzet e pesë euro] për një muaj dhe do të jepet për 8 muaj, gjithsej 1000 euro [njëmijë euro], gjegjësisht për periudhën dhjetor 2023 - korrik 2024;
- Numri i ndarjes së bursave është i kufizuar në 5 [pesë];

3. Dokumentet e nevojshme për konkurim

- ⇒ Formulari për aplikim që merret online dhe dorëzohet elektronikisht;
- ⇒ Kopja e letërnjoftimit apo e pasaportes [letërnjoftimi në dy anët];
- ⇒ Dëshmia me shkrim mbi regjistrimin si student/e i/e rregullt në v.a. 2023 / 2024;
- ⇒ Certifikata e notave e vitit paraprak [për studentët e vitit të II-të e tutje]
- ⇒ Dokumentacioni duhet të dorëzohet në email adresen: dren@thebalkanforum.org dhe drenusha@thebalkanforum.org
- ⇒ Dokumentet origjinale dorëzohen në zyrë të The BF vetëm nëse aplikuesi hyn në listë të ngushtë dhe njoftohet nga zyrtaret e The BF.

4. Afati i konkurrimit/aplikimit: deri më 24 dhjetor 2023. Dokumentet që arrijnë pas këtij afati nuk do të pranohen.

*Vetëm kandidatet që hyn në listë të ngushtë do të kontaktohen nga ekipi i
The Balkan Forum*